

BREAKING NEWS

x

PAS ULTIMATUMIT TE AMBASADORES YURI KIM, GJYKATA I JEP GODITJEN FINALE IS...

AKTUALITET

Gjendet e vrarë me armë 49-vjeçarja pranë liqenit të Sharrës, shpallet në kërkim kunati

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
15 SHKURT 2019

Facebook

WhatsApp


Twitter

Email



Një tjetër grua e masakruar, një tjetër grua e qëlluar për vdekje me armë zjarri, vrasjet e grave siç duket nuk do kenë fund. Kryeqyteti do të gdhihej dje sërish me lajmin se një grua pasi ishte masakruar duke u goditur në fytyrë me sende të forta, do të qëllohej tre herë me armë zjarri. Lirie Xhepa, 49 vjeçe, do të gjendej pranë liqenit të Sharrës në shkurre, e masakruar nga kalimtarë të rastit, të cilët do të lajmëronin menjëherë policinë. Burime nga Policia thanë se gruaja është qëlluar me sende të forta në pjesë të ndryshme të trupit, dhe më pas autori e ka qëlluar 49-

vjeçaren, tre herë me armë zjarri e llojit pistoletë. Burimet thonë se gruaja e masakruar ka marrë një plumb në kokë, dhe dy në bark. Dyshimet referuar hetimeve të deritanishme çojnë drejt pistës së krimit në familje. Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se i dyshuar për vrasjen makabre të 49-vjeçares, është kunati i saj Dashmir Xhepa, i cili është shpallur në kërkim policor. Gjatë kontrollit në banesë e tij, policia nuk e ka gjetur aty kunatin e viktimës. Sipas grupit hetimor viktimë është vrarë në vend tjetër dhe jo aty ku u gjet trupi i saj. Sipas hetuesve trupi i gruas u hodh në ferra për të fshehur gjurmët. Dyshimet se vrasja u krye në vend tjetër shtohen dhe për faktin se në vendin e ngjarjes nuk u gjetën gëzhoja. Sipas hetuesve vrasja e 49-vjeçares është bërë rreth orës 21:00-22:00 të së mërkurës. Lirie Xhepa ishte larguar nga banesa pasditen e së mërkurës pa lenë adresë. Pasi nuk erdhi as në mëngjes, djemtë e saj shkuan në komisariat nr.6 për të denoncuar zhdukjen dhe aty morën edhe lajmin se nëna e tyre ishte ekzekutuar. 49-vjeçarja ishte e ve, prej 15 vitesh ajo ka humbur bashkëshortin dhe është nënë e 4 fëmijëve. Ajo jeton me dy djemtë e saj të vegjël ndërsa dy të tjerët i kishte në emigrim një në Angli dhe tjetri në Greqi. Ndërkohë, fqinjët e viktimës thonë se ajo ishte një grua punëtore dhe e urtë. Lirie Xhepa merrej me bujqësi dhe blegtori, ndërsa prej pak kohësh kishte filluar punë në një fabrikë këpucësh. Gruaja u gjet në shkurre nga banorë të zonës, ndërsa ishte e veshur hollë dhe jo me xhup, çka hedh dyshimet se mund të jetë vrarë në ambient tjetër dhe më tej është hedhur në shkurret e kodrave të liqenit të Sharrës. Nga ana e policisë janë shoqëruar disa persona të cilët mendohet se mund të kenë dijeni lidhur me krimin, teksa hetimet janë në vijim.



Hetimet

Policia e kryeqytetit me të mbërritur në vendin e ngjarjes nisi menjëherë hetimet. Uniformat blu të kryeqytetit kanë bërë shoqërimin e rreth 20 personave, të cilët mund të kenë dijeni për vrasjen, së bashku me banorët që kanë qenë të parët që kanë konstatuar trupin e pajetë. Nga dëshmitë e marra deri tani grupi hetimor po punon në dy pista për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Pista e parë ku po punon policia është ajo e konflikteve që Lirie Xhepa kishte me kunetërit e saj për pronësinë. Ndërsa pista e dytë ku grupi hetimor po punon është një konflikt që viktimë ka pasur prej kohësh ka pasur me vëllezërit e bashkëshortit, që dyshonin për një lidhje dashurie të 49-vjeçares. Fillimisht çështja po hetohej nga prokurori i Prokurorisë së Tiranës, Olsi Dada, por pas dyshimeve se krimi mund të jetë bërë nga kunati, hetime iu referuan Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Burime nga organi i akuzës së krimeve të rënda thonë për gazetën “Sot” se dyshimet kryesore janë se krimi është bërë për motive pronësie. Nga hetimet u zbulua se Lirie Xhepa është dhunuar nga kunati i saj dhe në vitin 2008, disa kohë pasi i ishte ndarë nga jeta bashkëshorti. Sipas grupit hetimor shkak për ngjarjen e rëndë mund të jetë bërë një konflikt i hershëm për pronën mes Liries dhe kunatit të saj, Dashamir Xhepa, i shpallur në kërkim si një nga autorët e dyshuar për ngjarjen. Burime thonë se konflikti mes Lirie Xhepës dhe kunatit të saj Dashamirit ka nisur që në 2008 për pronat. Madje në 2008 ajo ka shkuar në spital me shenja dhune në kokë por ka deklaruar se ka renë nga shkallët. Pas hetimeve në atë kohë policia ka zbuluar konfliktin dhe vetë gruaja ka treguar se është rrahur nga kunati. Ajo ka deklaruar në polici se ai e kishte kërcënuar me armë dhe me jetën e djemve. Pas këtij episodi ajo ka marrë edhe urdhër mbrojtje./Elvis MYRTA